
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË AGJENCINË KOMBËTARE TË PYJEVE



Tiranë, korrik 2026

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3**
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**3**
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**3**
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	**4**
II	**HYRJA**	**5**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**6**
2.	Identifikimi i çështjeve	**6**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	**6**
4.	Përgjegjësitë e audituesve	**6**
5.	Kriteret e vlerësimit	**6**
6.	Standardet e auditimit	**7**
7.	Metodat e auditimit	**7**
8.	Dokumentimi i auditimit	**7**
I!I.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**8**
1.	**Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	**8**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**	**8**
2.1.	Auditimi i Qeverisjes dhe sigurisë së informacionit	**8-13**
2.2	Auditimi i Sistemeve	**13-25**
IV.	**REKOMANDIME**	**26**

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", datë 27.11.2014, zhvilloi një auditim të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP) nga data 12.02.2026 deri më datë 31.03.2026.
Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.
Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit:

Agjencia Kombëtare e Pyjeve është institucioni përgjegjës për mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, si dhe përdorimin shumë funksional të burimeve të fondit pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare. Në funksionin e saj drejtues, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ushtron rolin e autoritetit përgjegjës për garantimin e performancës dhe efikasitetit të sektorit të pyjeve, duke siguruar standarde dhe metodologji për aktivitetet dhe operacionet e këtij sektori, koordinimin me palët e interesuara dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Gjithashtu, institucioni ka përgjegjësi për krijimin e një sistemi të përshtatshëm për mbledhjen, administrimin dhe transferimin e informacionit, si dhe për garantimin e standardeve lidhur me administrimin e fondit pyjor kombëtar.

b. Rëndësia e Institucionit dhe e auditimit të tij:

Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka një rol të rëndësishëm në administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, duke kontribuar në ruajtjen e burimeve natyrore dhe në zbatimin e politikave kombëtare në sektorin e pyjeve. Përmbushja efektive e funksioneve të saj mbështetet gjithnjë e më shumë në përdorimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, të cilat mundësojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për administrimin e veprimtarisë institucionale.
Auditimi i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit është i rëndësishëm për vlerësimin e masave të marra për garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave, si dhe për identifikimin e risqeve që lidhen me administrimin e sistemeve të informacionit, kontrollin e aksesit dhe mbrojtjen e burimeve teknologjike që mbështesin funksionet e institucionit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe objektivat:

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i mënyrës së qeverisjes, menaxhimit dhe kontrollit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, me synim përcaktimin nëse strukturat, proceset, politikat dhe masat e kontrollit të zbatuara sigurojnë administrimin efektiv, të sigurt dhe të qëndrueshëm të burimeve të TI-së në mbështetje të objektivave dhe funksioneve institucionale.
Auditimi është kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2025, në zbatim të programit të auditimit nr. 1209/1, datë 13.02.2026, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Në kuadër të auditimit është vlerësuar qeverisja e Teknologjisë së Informacionit, administrimi i sistemeve të informacionit, masat e sigurisë së informacionit, kontrolli i aksesit, menaxhimi i burimeve teknologjike dhe kontrollet e vendosura për garantimin e disponueshmërisë dhe integritetit të të dhënave.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Në realizimin e auditimit është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku, duke u fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e fushave me ekspozim më të lartë ndaj risqeve të Teknologjisë së Informacionit. Përzgjedhja e subjektit të auditimit është bazuar në analizën e riskut të kryer gjatë hartimit të Planit Vjetor të Auditimit të KLSH-së dhe Programit të Projektit të Auditimit. Qasja audituese është mbështetur në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit të KLSH-së, duke përdorur metoda të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave përmes shqyrtimit të dokumentacionit, intervistave me strukturat përgjegjëse, plotësimit të pyetësorëve të auditimit, verifikimit të evidencave të vëna në dispozicion dhe analizimit të kontrolleve ekzistuese të sistemeve të informacionit.
Evidencat e administruara gjatë punës në terren janë vlerësuar si të mjaftueshme dhe të besueshme për mbështetjen e konkluzioneve të auditimit.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në raportin e auditimit janë formuluar 14 gjetje dhe 14 rekomandime për masa organizative.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Nga verifikimet mbi testimin e sistemit për mirëfunksionimin e tij, konstatohet se implementimi nuk është përmbyllur plotësisht dhe në përputhje me Termat e Referencës të përcaktuara në kontratë. Një pjesë e funksionaliteteve dhe zhvillimeve të sistemit janë ende në proces, ndërsa disa të tjera janë realizuar pjesërisht. Konkretisht:

- Nuk është realizuar plotësisht, brenda afatit të implementimit, konfigurimi në sistem i dy shërbimeve që ofrohen nëpërmjet e-Albania, si: aplikimi për ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, si dhe aplikimi për lëshimin e certifikatës së ekspertit për pyjet dhe kullotat. Menaxhimi i këtyre shërbimeve nëpërmjet sistemit ALFIS është jashtë funksionit, pasi në ekran shfaqet vetëm shenja "error";
- Hartat e vitit 1985, të gjeoreferuara për orientim në hartimin e planeve të menaxhimit (PM) të reja, janë realizuar pjesërisht, pasi në sistem janë aktive vetëm bashkitë: Bulqizë, Dibër, Kamëz dhe Himarë;
- Gjenerimi i raporteve automatike në format Excel dhe PDF të regjistrit kadastral ka nevojë për formatim dhe rishikim;
- Gjenerimi i përshkrimit parcelar në format PDF, ku paraqiten të dhënat bazë të një parcele pyjore, është realizuar pjesërisht dhe kërkon rregullim të formatit;
- Automatizimi i proceseve të përditësimit të sistemit për Inventarin Kombëtar të Pyjeve dhe përshtatja e aplikacionit OPEN-FORIS me sistemin ALFIS janë ende në proces.

- Kontrata për përmirësimin e sistemit Shqiptar të Integruar të informacionit për pyjet (ALFIS) përfshin disa përmirësime të funksionaliteteve dhe në 3 module. Këto përmirësime lidhen me komponentë softuerik, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme të vlerës së këtij komponenti.
-Të dhënat shtetërore të sistemit shqiptar të informacionit për pyjet (ALFIS), si dhe infrastruktura fizike e këtij sistemi, hostohen në datacenter-in qeveritar të AKSHI-t. Si site primar ashtu edhe site sekondar ndodhen në të njëjtin datacenter. Konstatohet se site sekondar nuk është vendosur në një largësi gjeografike në përputhje me kërkesat e VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit" dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Sipas këtyre praktikave, ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë në një pozicion gjeografik me risk të ulët për t'u prekur nga i njëjti incident apo fatkeqësi natyrore si ambienti primar, me një distancë minimale prej 50 km në vijë ajrore.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për realizimin e të gjitha funksionaliteteve, në zbatim të Termave të Referencës, sipas Kontratës nr. 121, datë 24.12.2024 "*Përmirësimin e sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)*".
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me AKSHI, duhet të ndërmarrë masa për çaktivizimin e shërbimeve të pasigurta të aksesueshme publikisht, si Telnet në domenin "alfis.gov.al", dhe të zëvendësojë ato me protokolle të sigurta, si SSH, me qëllim uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve të sigurisë**.**
-Agjencia Kombëtare e Pyjeve t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masat e nevojshme për vendosjen e site-it sekondar të sistemit ALFIS në një largësi gjeografike, sipas standardeve të kërkuara

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit:

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimet në sektorin publik, ISSAI 5300 - Udhëzime për auditimin e IT-së dhe ISSAI 5310 - Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*". Nga auditimi i kryer, është evidentuar se
Sistemi ALFIS i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve nuk është administruar në përputhje të plotë me kërkesat rregullatore, kontraktuale dhe praktikat më të mira të teknologjisë së informacionit. Mangësitë e konstatuara tregojnë një nivel të pamjaftueshëm të qeverisjes së TI, duke filluar nga mungesa e burimeve njerëzore të specializuara deri tek mungesa e politikave dhe procedurave të formalizuara për menaxhimin e sistemeve të informacionit.
Kontrata për përmirësimin e sistemit Shqiptar të Integruar të informacionit për pyjet (ALFIS) përfshin disa përmirësime të funksionaliteteve dhe në 3 module. Këto përmirësime lidhen me komponentë softuerik, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme të vlerës së këtij komponenti.
Në aspektin teknik dhe funksional, sistemi nuk rezulton i përfunduar dhe i konsoliduar plotësisht, pasi një pjesë e funksionaliteteve të parashikuara në kontratë janë të papërfunduara, të realizuara pjesërisht ose jo funksionale në praktikë.
Gjithashtu, janë evidentuar dobësi të konsiderueshme në drejtim të sigurisë së informacionit, përfshirë mangësi në mekanizmat e autentifikimit, ekspozim të shërbimeve dhe menaxhim jo të rregullt të përdoruesve me të dhëna të paplota dhe jozyrtare. Në tërësi, këto problematika rrisin ndjeshëm riskun për akses të paautorizuar, humbje të gjurmueshmërisë dhe kompromet im të të dhënave, duke ndikuar negativisht në funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit ALFIS.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1209/1, datë 13.02.2026, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 13.02.2026 deri në 31.03.2026, në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve , (më poshtë AKP), ku periudha e audituar është 01.01.2024 deri në 31.12.2025, u krye auditimi me objekt "*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*", nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. B.A, anëtar
3. K.S, anëtare

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i auditimit është vlerësimi i përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të teknologjisë së informacionit nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, me fokus tek ekzistenca dhe efektiviteti i kontrolleve kryesore për mbrojtjen e të dhënave. Auditimi ka pasur për qëllim të përcaktojë nëse praktikat e ndjekura janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të AKP dhe standardet e sigurisë së informacionit, si dhe nëse sigurohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit. Qëllimi i auditimit të kryer në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve është të ofrojë një vlerësim të pavarur mbi gjendjen aktuale të kontrolleve të teknologjisë së informacionit, në raport me menaxhimin, sigurinë, mirëmbajtjen dhe përdorimin e infrastrukturës ekzistuese. Auditimi synon të identifikojë dobësitë dhe proceset teknologjike, të vlerësojë rreziqet e mundshme. Për realizimin e këtij qëllimi, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna, dokumente, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310.

II.2 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr. 1209/1, datë 13.02.2026.
1.Auditimi i Qeverisjes dhe sigurisë së informacionit
2.Auditimi i Sistemeve

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, duke synuar ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve të fondit pyjor kombëtar, si një pasuri natyrore me rëndësi të veçantë publike. Në këtë kuadër, strukturat drejtuese të institucionit mbajnë përgjegjësi thelbësore për orientimin strategjik, organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë veprimtarisë në sektorin e pyjeve.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe politikat kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve. Ato sigurojnë drejtimin dhe koordinimin e proceseve administrative dhe teknike që lidhen me administrimin, ruajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor, duke garantuar zbatimin korrekt të legjislacionit dhe standardeve përkatëse.
Në ushtrimin e funksioneve të tyre, strukturat drejtuese luajnë një rol kyç në koordinimin ndërinstitucional, duke bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet qendrore dhe aktorë të tjerë të interesuar, me qëllim sigurimin e një qasjeje të integruar në menaxhimin e burimeve pyjore. Njëkohësisht, ato janë përgjegjëse për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave efektivë për mbledhjen, administrimin dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe për garantimin e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave mbi fondin pyjor.

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri në 31.12.2025, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.
Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 1209/1, datë 13.02.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien

e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT, ISO/IEC 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji Nr. 43/2023 "*Për Qeverisjen Elektronike*";
- Ligji Nr. 25/2024, "Për Sigurinë Kibernetike";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 "Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore";
- Vendim i Kuvendit nr. 3/2023 për miratimin e Planit Vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",* i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar;
- Rregullore e Brendshme - Agjencia Kombëtare e Pyjeve
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310.

II.7 Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve , janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;

- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi.

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), është institucion publik qendror në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për sektorin e pyjeve, i cili ushtron juridiksionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e saj mbështetet në kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës, konkretisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 17.07.2019 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve", si dhe në aktet e tjera rregullatore që përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe funksionimin e saj.
Struktura organizative, organigrama dhe struktura e pagave të Agjencisë janë miratuar me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 192, datë 18.11.2022, i cili përcakton organizimin e brendshëm të institucionit, ndarjen e funksioneve, pozicionet e punës dhe nivelet përkatëse të pagave. Nëpërmjet kësaj strukture synohet sigurimi i një funksionimi efikas administrativ dhe teknik, në përmbushje të detyrave të institucionit. Agjencia Kombëtare e Pyjeve financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, duke ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe eficencës në përdorimin e burimeve publike. Ajo gëzon pavarësi në vendimmarrje dhe në ushtrimin e funksioneve të saj, brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Misioni i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve është mirëqeverisja e pyjeve në nivel kombëtar, duke garantuar ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, si dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe shume funksional të burimeve të fondit pyjor kombëtar, si një pasuri natyrore me rëndësi të veçantë për vendin. Në funksion të këtij misioni, AKP ushtron një rol kyç në administrimin, monitorimin dhe kontrollin e fondit pyjor, si dhe në zbatimin e politikave shtetërore në këtë sektor. Funksionet dhe detyrat e Agjencisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, miratuar me Urdhrin Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 178, datë 20.05.2022, e cila përcakton organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave përbërëse të saj. Në këtë kuadër, AKP është përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve në sektorin e pyjeve, bashkëpunimin me institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe për garantimin e standardeve dhe metodologjive në administrimin e fondit pyjor. AKP ka përgjegjësi për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të informacionit që mbështesin menaxhimin e të dhënave pyjore, duke mundësuar mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e informacionit në funksion të vendimmarrjes dhe raportimit. Në këtë drejtim, ajo kontribuon në rritjen e transparencës, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë në menaxhimin e burimeve pyjore. Selia e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ndodhet në Tiranë dhe institucioni disponon vulën e tij zyrtare, duke ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 *Auditimi i Qeverisjes dhe Sigurisë së Informacionit*"

Në zbatim të pikës 1 "*Auditimi i Qeverisjes dhe Sigurisë së Informacionit*" të Programit të Auditimit nr. 1209/1, datë 13.03.2026 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi;
- Regjistër risku si dhe planet e menaxhimit të tij për periudhën e audituar;
- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së informacionit në AKP;
- Skema e komunikimit të network-ut;
- Etj.

Auditimi i funksionimit të Qeverisjes dhe Sigurisë së Informacionit


a. Struktura organizative e AKP për sistemet TIK

Agjencia Kombëtare e Pyjeve është krijuar me VKM-së nr. 570, datë 17.07.2019 *"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve"*, i ndryshuar. AKP-ja ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, shfrytëzimin e qëndrueshëm e shumë funksional të burimeve pyjore, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.
AKP-ja ka këto përgjegjësi:

- Sigurimin e performancës në sektorin e pyjeve;
- Vlerësimin e gjendjes së pyjeve;
- Organizimin e punës për inventarizimin dhe kërkimin në fushën e pyjeve;
- Organizimin e punës dhe hartimin e dokumenteve për menaxhimin e pyjeve;
- Organizimin e punës për monitorimin dhe kontrollin e pyjeve.

Për kryerjen e funksioneve institucionale Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 192, datë 18.11.2022 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve"* e cila është e ndërtuar mbi bazën e tre Drejtorive dhe nëntë Sektorëve.

Diagrama nr.1: Organigrama e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve



Burimi: AKP

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve është 32 punonjës nga të cilët 3 janë vende vakante. Detyrat specifike dhe përshkrimet e punës së punonjësve të AKP-ës janë pjesë përbërëse e Rregullores së brendshme me nr. 3662/2 prot., datë 20.05.2022 *"Rregullore e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve"",* miratuar me urdhër nr. 178, datë 20.05.2022, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Nga auditimi u konstatua se drejtoritë dhe sektorët përkatës në Rregulloren e Brendshme të AKP miratuar me urdhër e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 178, datë 20.05.2022, nuk përputhet me strukturën aktuale të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 192, datë 18.11.2022, si dhe konstatohen mos përputhje të detyrave të punonjësve në përshkrimet e punës me rregulloren e brendshme. Konkretisht për stafin e Sektorit të Informacionit dhe Regjistrit Kombëtar i cili ka në administrim dhe përdorim sistemin ALFIS, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme mbi mënyrën e organizimit, funksionimit dhe ndarjes së përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, nuk janë në përputhje me përshkrimet e punës dhe ne përputhje me rregulloren e ALFIS.

Për periudhën objekt auditimit AKSHI ka atashuar specialist IT-në AKP, ku disa detyra të tij janë caktuar në rregulloren e brendshme të AKP, konkretisht*:*
Nga auditimi konstatohet se në rregulloren e brendshme të AKP janë përcaktuar dhe detyrat e specialistit të AKSHI-t i atashuar në AKP, i cili kryen funksionet dhe detyrat si më poshtë:
Kreu IV, neni 15 "Rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike"
1. Përdorimi i rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike në AKP menaxhohen nëpërmjet AKSHI.
Neni 16, "Posta elektronike"
2. Specialisti i IT nga AKSHI monitoron postën elektronike dhe përdorimin e internetit. Ai nuk ka të drejtë privatësie në krijimin, dërgimin apo marrjen e një e-mail.
Neni 17, "Përditësimin i faqes së internetit"
1.b) Hedhja e të dhënave në faqen zyrtare bëhet nga specialisti IT-së që është nën varësi të AKSHIT.
1.c) AKSHI, që përgjigjet për mbarëvajtjen teknike të faqes së internetit.
Nga auditimi u konstatua se, aktualisht në strukturën e AKP nuk ka asnjë punonjës të teknologjisë së informacionit, duke ekspozuar risk të lartë sigurie për përdorimit e sistemeve dhe pajisjeve TIK .

Nga auditimi u konstatua se, AKP disponon në inventar 47 pajisje kompjuterike, nga të cilat vetëm 19 janë në përdorim. Gjithashtu, institucioni ka 30 printera, prej të cilëve 11 janë funksionalë dhe në përdorim, si dhe 6 fotokopje, nga të cilat vetëm 2 përdoren aktualisht. U evidentua se një pjesë e konsiderueshme e pajisjeve të teknologjisë së informacionit ndodhen të magazinuara, pa u vlerësuar për gjendjen teknike dhe funksionalitetin e tyre

Nga auditimi konstatohet se AKP nuk e ka përfunduar procesin e dorëzimit të Infrastrukturës hardware TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko civilë sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, *"Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit"*, i ndryshuar.

b. Politikat aktet rregullatorë të standardeve në TIK

Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

Është e rëndësishme pasja e një Strategjinë e IT për institucionin në të cilën të përcaktohet shtrirja e Qeverisja e IT ka qenë pjesë e vendimmarrjes së institucionit mbi Strategjinë e IT.

Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka një strategji institucionale e cila të ketë të përfshirë edhe strategjinë mbi teknologjinë e informacionit për të mbështetur objektivat institucional dhe ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, si dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në AKP, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës. Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

-Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke patur në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij. U verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni, si dhe udhëzime të tjera të brendshme dhe konstatohet se, Teknologjia e Informacionit në Agjencinë Kombëtare të pyjeve zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. Rregullat e sistemii TIK bazohen vetëm në detyrat e kufizuara të specialistit të IT-së nga AKSHI i cili administron pajisjet dhe rrjetin kompjuterik në pronësi të AKP-së.

AKP nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së teknologjisë se informacionit, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre, etj, kjo jo në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022.

Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

c. Trajnimet

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë.
Bazuar në përshkrimet e punës për punonjësin përgjegjës i Sektorit të Informacionit dhe Regjistrit vënë në dispozicion grupit të auditimit, një ndër detyrat kryesore të përgjegjësit të Sektorit të Informacionit dhe Regjistrit Kombëtar është:
- *"Harton programin dhe organizon trajnime për specialistët e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Njësive të Vetëqeverisjes Vendore/Bashkive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, me qëllim njohjen, përvetësimin me Sistemin Shqiptar të Integruar të Informacionit (ALFIS) për fondin pyjor dhe kullosor kombëtar, si dhe njohjen e zhvillimin e praktikave të raportimit të të dhënave sipas formateve të kërkuara nga organizatat homologe Europiane;"*
- *"Përcakton nevojat dhe përgatit materialet e trajnimeve për specialistët e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Njësive të Vetëqeverisjes Vendore/Bashkive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, me qëllim njohjen, përvetësimin me Sistemin Shqiptar të Integruar të Informacionit (ALFIS) për fondin pyjor dhe kullosor kombëtar, si dhe njohjen e zhvillimin e praktikave të raportimit të të dhënave sipas formateve të kërkuara nga organizatat homologe Europiane;"*

Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion vetëm një plan trajnimi më datë 18.03.2025, nga Operatori Ekonomik për sistemin ALFIS, ku përfshihen stafi i agjencive të përfshira në zbatim të kontratës n. 121 prot., datë 24.12.2024 me objekt "Përmirësimi i Sistemit Shqiptar të Integruar të Informacionit në Pyje (ALFIS) - për Agjencinë Kombëtare të Pyjeve".

Nga auditimi konstatohet se nuk ka dokumentacion për vërtetimin nëse janë kryer këto trajnime për stafin e AKP, si dhe nuk ka dokumentacione të administruar mbi propozimet përkatëse, për zhvillimin e trajnimeve specifike. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet dhe teknologjinë e informacionit.

-Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Pyjeve për periudhën objekt auditimi vitet 2024 dhe 2025, nuk ka pasur plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të cilët mbulojnë pjesën e administrimit të sistemit ALFIS, si dhe punonjës të cilët janë përdorues të pajisjeve dhe sistemeve teknologjike.

c. Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK

Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuara, monitorimit të rreziqeve të identifikuara më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.
Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra rreziku i institucionit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.
- *Nga auditimi u konstatua se,* Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk disponon regjistër risku për teknologjinë e informacionit, në asnjë formë nuk rezulton të jenë dokumentuar risqe të identifikuara për periudhën e audituar. Kjo në kundërshtim me nenin 11, pika 2: "*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*", 12 pika 3/d: "*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata*

drejtojnë" si dhe nenin 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 "*Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve*", Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike",* AKP duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

d. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Siguria e informacionit është e rëndësishme për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Auditimi i sigurisë së informacionit identifikon sfidat dhe rreziqet e mundshme në nivelin e sigurisë së informacionit dhe ndihmon në zhvillimin e strategjive për t'i përballuar ato. Në të njëjtën kohë, ai identifikon politikat dhe procedurat e sigurisë së informacionit dhe vlerëson se a janë ato të përshtatshme dhe të ndjekura me përpikëri nga punonjësit e Institucionit.

Infrastruktura e rrjetit në AKP është e ndërtuar mbi një lidhje interneti me fibër optike të administruar nga "D". Topologjia e rrjetit përbëhet nga lidhja Internet (ISP), e cila transmetohet në një pajisje ONT Nokia të konfiguruar në mënyrën *bridge*, dhe më pas trafiku kalon në një pajisje router Mikrotik RB952Ui-5ac2nD që menaxhon adresimin IP dhe trafikun e rrjetit. Routeri shërben njëkohësisht si router kryesor, switch dhe pikë aksesi (Wi-Fi), duke furnizuar rrjetin e brendshëm (LAN/Wi-Fi) të institucionit.
Në aspektin e pajisjeve të rrjetit, institucioni përdor ONT Nokia për ndërprerjen e lidhjes me fibër optike dhe routerin Mikrotik RB952Ui-5ac2nD për menaxhimin e rrjetit. Nuk përdoret një pajisje e dedikuar firewall (hardware firewall), pasi funksionet e mbrojtjes së rrjetit realizohen përmes mekanizmave të firewall-it të integruar në routerin Mikrotik.
Firewall-i është i konfiguruar sipas parimit "minimum access", duke lejuar vetëm trafikun e nevojshëm dhe duke kufizuar akseset e panevojshme nga rrjeti i jashtëm. Gjithashtu, është deklaruar se kredencialet standarde (default) të pajisjeve të rrjetit janë ndryshuar me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë dhe parandalimin e aksesit të paautorizuar.
Lidhur me vazhdimësinë e shërbimit, aktualisht institucioni nuk disponon lidhje interneti redundante (backup). Në rast të ndërprerjes së linjës primare me fibër optike, nuk ekziston një lidhje alternative për sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit. Megjithatë, sipas sqarimeve të dhëna, ofruesi i shërbimit të internetit operon me disa lidhje ndërkombëtare dhe tipologji të ndryshme brenda rrjetit të tij, çka lidhet me infrastrukturën e ofruesit dhe jo me një zgjidhje redundante të implementuar në nivel institucioni.

Nga auditimi u konstatua se:
-Institucioni nuk disponon dokumentacion zyrtar, të miratuar dhe të përditësuar që përshkruan arkitekturën e rrjetit, topologjinë, pajisjet dhe konfigurimet bazë, në kundërshtim me kërkesat e ISO/IEC 27001:2022 dhe udhëzimet e AKSHI për menaxhimin e infrastrukturës IT.

-Mbrojtja e rrjetit institucional realizohet përmes funksionalitetit të integruar në router-in Mikrotik, pa përdorimin e një pajisjeje firewall të dedikuar, në kundërshtim me ISO/IEC 27001:2022.

-Institucioni përdor vetëm një lidhje primare interneti dhe nuk ka të implementuar lidhje redundante (backup), në kundërshtim me ISO/IEC 27001:2022

Nga auditimi u konstatua se firewall-i i rrjetit është i konfiguruar sipas parimit të "aksesit minimal" dhe kredencialet default të pajisjeve të rrjetit janë ndryshuar, në përputhje me ISO/IEC 27001:2022 .

-Në infrastrukturën e publikuar nën domenin alfis.gov.al, e administruar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, rezulton e hapur dhe e aksesueshme publikisht porta 23/TCP (Telnet).
-Gjatë verifikimit teknik u evidentua se shërbimi Telnet është i arritshëm nga rrjeti publik (Internet) dhe sistemi paraqet një prompt autentikimi interaktiv për vendosjen e emrit të përdoruesit (Username). Gjithashtu, gjatë tentativës së lidhjes shfaqet një banner zyrtar paralajmërues i rrjetit qeveritar, duke konfirmuar se shërbimi është aktiv dhe i ekspozuar ndaj aksesit nga jashtë rrjetit.

Në zbatim të pikës 2 "*Auditimi i Sistemeve*" të Programit të Auditimit janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër "Sistemi Shqiptar të Informacionit për Pyjet, (ALFIS)" si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij si:

- Aktet rregullative që lidhen me sistemin ALFIS;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara në sistem;
- Vizita në terren;
- Indikatorë dhe statistika,
- Konsultim me faqen e web-it të AKP, etj.

2.2. Zhvillimi, implementimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes së Sistemit Shqiptar të Informacionit për Pyjet, (ALFIS).

U konstatua se, Banka Botërore, nëpërmjet Projektit të Shërbimeve Mjedisore pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në vitin 2018 ka financuar ngritjen dhe funksionimin e "Sistemit Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)". Ky sistem është një platformë gjeografike e hapur për komunikim dhe ndërveprim mes agjencive përgjegjëse për pyjet dhe pushtetit vendor dhe ofron të gjitha funksionet për menaxhimin e Kadastrës Pyjore dhe menaxhimin e planeve të mbarështimit për pyjet bashkiake, duke integruar komponentët gjeografikë me informacionin pyjor.
Të gjitha të dhënat pyjore të përfshira në ALFIS janë të dhëna historike të vitit 1985 dhe të dhëna të ndryshme të përditësimit, bazuar në VKM-të e transferimit dhe në varësi të punës së kryer nga çdo bashki individualisht.
Sistemi ALFIS përmbush misionin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për "mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare".

Në përfundim të procedurave të prokurimit të realizuar në vitin 2018, sipas udhëzuesve dhe guidave të Bankës Botërore, MTM, nëpërmjet Projektit të Shërbimeve Mjedisore, ka lidhur kontratën nr. 8368/1, datë 06.12.2018 për "Sistemin Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)", me fituesin e tenderit, bashkimin e operatorëve ekonomikë "A.S. & FBS sh.p.k". Përfitues i këtij investimi është Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.
Vlera totale e kontratës është 375,000 Euro pa TVSh dhe 450,000 Euro me TVSh vlerë e cila përfshin të gjithë software-ët për zhvillimin e sistemit (ALFIS) me vlerë 210,000 Euro pa TVSH dhe pajisjet hardware (pajisjet e sistemit) me vlerë 165,000 Euro pa TVSH.
Preventivin e kësaj kontrate po e pasqyrojmë, më poshtë:

Euro

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	**Software-ët për zhvillimin e ALFIS**				
1.1	Projektimi dhe zhvillimi ALFIS duke përfshirë prodhimin e specifikimeve të përdoruesit dhe specifikimeve të ALFIS që plotësojnë të gjitha kërkesat e përshkruara në Specifikimet e këtij Dokumenti Ofertimi	op	1	84,000	84,000
1.2	Zhvillimi i dokumenteve të udhëzimeve për përdoruesit, zhvilluesit dhe administratorët	op	1	42,000	42,000
1.3	Instalimi dhe testimi	op	1	63,000	63,000
1.4	Trajnimi	op	1	21,000	21,000
	Vlera e Software-ve për zhvillimin e ALFIS				**210,000**
2	**Pajisjet (Supply of Hardware)**				
2.1	Server	cope	8	7,700.	61,600.
2.2	Storage	cope	2	16,600.	33,000
2.3	Switch	cope	4	1,000	4,000
2.4	Router	cope	4	1,100.	4,400
2.5	Firewall	cope	4	7,900	31,600
2.6	SAN Switch	cope	4	3,500.	14,000.
2.7	UPS	cope	2	3,100.	6,200
2.8	Tape library	cope	1	9,400	9,400
2.9	Tape media (pack 20 unit)	cope	1	800	800
	Vlera e Pajisjeve (Supply of Hardware)				**165,000**
	Totali, pa TVSH (Software + Hardware)				**375,000**
	TVSH 20%				**75,000**
	Totali, me TVSH (Software + Hardware)				**450,000**

Kjo kontratë përbëhet nga sistemin gjeografik i cili ka për qëllim të menaxhojë të gjithë procesin e informacionit që do të mblidhet dhe mbahet nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin dhe monitorimin e fondit pyjor dhe kullosor. Kontrata përmban module për zhvillimin e software-ve dhe pajisjet e infrastrukturës si më poshtë:

-Modulet:

1. GIS DATA;
2. BPM MANAGER;
3. DOCUMENT;
4. FMP PROJECT;
5. CATALOGUE;
6. REGISTERY;
7. GIS PUBLISHER;
8. USER MANAGMENT.

Infrastruktura fizike Hardware e cila është e hostuar në ambientet e AKSHI përbëhet nga:

8 Server;
2 Storage;
4 Switch;
4 Router;
4 Fireëall;
4 SAN Switch;
2 UPS
1 Tape library;

1 Tape media (pack 20 unit).

Gjithashtu, infrastruktura IT e ALFIS bazohet edhe në 5 server virtualë, si më poshtë:
• Server publik;
• Server aplikacionesh;
• Server web;
• Server rezervë;
• Server testimi.
Nga 5 serverët virtual 2, prej tyre përdoren për shtresat e të dhënave, me qëllim nëse njëri është jashtë funksionit, mbulohet nga serveri tjetër kështu që menaxhohen dëmet e papritura, ndërsa 2 serverë përdoren për Virtualizim e shtresave të aplikacionit dhe web-it (serverët virtualë për zbatimin e sistemit në tërësi) dhe një server tjetër përdoret për testimin.

Kontrata ka filluar efektet e zbatimi me nënshkrimin e saj nga palët në datën 27.11.2018. Sipas kushteve të kontratës, periudha e implementimit të sistemit (ngritjes së sistemit) është përcaktuar 10 muaj nga data efektive dhe në përfundim të kësaj faze pas marrjes në dorëzim të sistemit (pranimit) përcaktohet periudha e mirëmbajtjes dhe suportit të sistemit me afat 6 mujor dhe periudha e garancisë së defekteve të sistemit me afat 36 muaj.
Konstatohet se, kontrata ka përfunduar në Mars të vitit 2022. Me përfundimin e afatit të garancive të defekteve operatori ekonomik u çliruar nga detyrimet dhe përgjegjësitë e kujdesit dhe mbështetjes për mirëfunksionimin e sistemit dhe pas kësaj periudhe sistemi mbeti i pa mbuluar me mirëmbajtje teknike duke ka krijuar rrezik të lartë për vazhdimësinë e shërbimit dhe integritetin e të dhënave pyjore. *Në këto kushte AKP mbas përfundimit të kësaj kontrate nuk e ka futur në punë dhe përdorur sistemin ALFIS*.

Nga AKP, si institucioni përfitues i sistemit, nuk u vu në dispozicion të auditimit ndonjë shkresë zyrtare apo email zyrtar drejtuar MTM-së si autoritet kontraktor dhe AKSHI-së si Administrator i Sistemeve TIK, për inicimin e fillimit të shërbimit të mirëmbajtjes ose kërkesë për fonde për mbulimin e këtij shërbimi nga vetë AKP. Por AKSHI, në zbatim të VKM-së Nr. 673, datë 22.11.2017 "Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", në përfundim të afateve të kontratës, me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 62, datë 14.02.2022, ka ngritur grupin e punës "Për hartimin e termave të referencës (ToR) për procedurën e prokurimit me objekt ***"Mirëmbajtja e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)"***. Në këtë grup pune janë përcaktuar edhe dy përfaqësues nga institucioni përfitues AKP, të caktuar me shkresën nr. 67/1 prot., datë 09.02.2022.
Përfaqësuesit e AKP-së kanë draftuar termat e referencës për "Mirëmbajtja e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)" dhe i kanë dërguar ato me e-mail më datë 02.03.2022 në AKSHI për vijimin e procedurave të prokurimit.
Me marrjen e draftit të termave të referencës, AKSHI, me shkresën Nr. 7379, datë 21.11.2022, "Mbi procedurën me objekt: 'Mirëmbajtja e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)", ka njoftuar AKP, duke bërë me dije dhe MTM-së:
"Grupi i punës vijoi me hartimin e termave të referencës, duke marrë në konsideratë kërkesat e dërguara me email nga AKP gjatë draftimit të termave të referencës, kërkesa të cilat shkojnë përtej logjikës teknike dhe aneksit teknik të mirëmbajtjes. Shumica e përmirësimeve të kërkuara duhet të ishin menduar dhe implementuar që në fillim të projektit, në mënyrë që të mos kërkoheshin për t'u shtuar në këtë fazë mirëmbajtjeje."
"Vlen për t'u theksuar se të gjitha përmirësimet e kërkuara vetëm tani nga ana juaj duhet të ishin implementuar gjatë projektit me financim të huaj, sepse janë kryesisht zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi."
*"Sa më sipër, lutemi të caktoni një përfaqësues nga ana juaj me qëllim ngritjen e grupit të punës për rishikimin e termave të referencës për procedurën me objekt "**Përmirësimin e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)**".*

Në përgjigje të kësaj kërkese të AKSHI-së, AKP ka ngritur grupin e punës për rishikimin e termave të referencës dhe ndryshimin e objektit të procedurës së prokurimit nga "Mirëmbajtja e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)" në "Përmirësimin e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)". Me email më datë 12.12.2022, AKP e ka njoftuar AKSHI-n.
Më tej, rreth 14 muaj më vonë, AKP, me shkresën nr. 129, datë 01.02.2024, dërguar AKSHI-së, ka ngritur shqetësimin për procedurat lidhur me "Përmirësimin e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)", duke deklaruar:
"*AKP, nëpërmjet kësaj shkrese, ngre shqetësimin për vonesat në përfundimin e procedurave të tenderimit për 'Përmirësimin e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)'."*
"Në bazë të urdhrit të përbashkët të AKSHI-së dhe AKP-së, më datë 12.12.2022 kanë filluar procedurat e tenderimit, ku AKP u angazhua për hartimin e termave të referencës, të përfunduara në shtator 2023, siç dokumentohet edhe nëpërmjet komunikimit zyrtar prokurimet@akshi.gov.al. Rëndësia e përfundimit sa më shpejt të procesit të tenderimit lidhet me rëndësinë që ka ALFIS në miradministrimin e fondit pyjor si një databazë dhe platformë gjeografike e hapur për komunikim dhe ndërveprim mes AKP, MTM, bashkive, drejtorive rajonale të zonave të mbrojtura, pronarëve privatë të pyjeve etj."

Duhet theksuar se termat e referencës për procedurën e prokurimit me objekt "Përmirësimin e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)", të dërguar nga AKP me e-mailin datë 01.09.2023, janë të njëjta me termat e referencës të dërguara nga AKP më datë 02.03.2022, të kërkuara nga vetë AKSHI për fillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtja e sistemit Shqiptar të integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)".
Pra, nevoja për përmirësimin sistemit ALFIS është identifikuar nga AKSHI dhe jo nga vet AKP që është përfituesi dhe përdoruesi i këtij sistemi.

Përsëri, pas 7 muajsh, AKP, me shkresën nr. 129/4, datë 24.09.2024, "Kërkesë urgjente për domosdoshmërinë e vënies në përdorim të sistemit ('Sistemi Shqiptar i Integruar i Informacionit për Pyjet' – sistemi ALFIS), i ka kërkuar AKSHI-t se:
"Në përfundim të komunikimit zyrtar me ju për procedurat e tenderimit për përmirësimin e Sistemit Shqiptar të Integruar të Informacionit për Pyjet (ALFIS), ku me shkresën tuaj nr. 629, datë 07.02.2024, keni kërkuar konfirmimin e fondeve në dispozicion për përmirësimin e këtij sistemi, në përgjigje të saj ju kemi bërë me dije se AKP nuk ka parashikuar fonde për zhvillimin e kësaj procedure për vitin 2024.
Për sa më sipër, për shkak të pamundësisë së financimit nga ana jonë për përmirësimin e këtij sistemi dhe duke u nisur nga rëndësia e përdorimit të tij në menaxhimin dhe kontrollin e fondit pyjor, kërkojmë në urgjencë vënien në përdorim të ALFIS në gjendjen aktuale.
Rëndësia e përdorimit të sistemit në gjendjen aktuale lidhet me rolin e ALFIS-it në miradministrimin e fondit pyjor si një databazë dhe platformë gjeografike, ku integrohet i gjithë informacioni mbi pyjet, duke siguruar dhe standardizuar ndërveprimin mes AKP, MTM, 61 bashkive, drejtorive rajonale të zonave të mbrojtura, pronarëve privat të pyjeve etj."

Si përfundim, bazuar në objektin e procedurës, grupi i punës i ka hartuar termat e referencës për përmirësimin e sistemit dhe termat e referencës për mirëmbajtjen e sistemit, si më poshtë:

Propozimet e termave të referencës të hartuara për përmirësimin e sistemi:

A. Parallogaritje të parametrave morfologjikë të parcelave pyjore
B. Përmirësimi/Modifikimi i bazës qendrore të të dhënave të aplikacionit OPEN FORIS për integrimin me ALFIS

C. Integrimi ALFIS – OPEN FORIS app dhe llogaritja e indikatorëve nga të dhënat e Sipërfaqeve Test dhe ngarkimi automatik në DB ALFIS
D. Moduli i Planifikimit Vjetor në ALFIS
E. Rishikimi manualeve, ndihma në internet dhe integrimi i trajnimit
F. Ndërhyrje shtesë në bazën e të dhënave ALFIS
G. Funksionalitet për Menaxhimin në portalin e-albania
H. Krijimi i një shtrese për vendosjen e sipërfaqeve prove të përhershme të një PM dhe të dhënat e terrenit që do të shërbejnë për llogaritjen e parametrave të parcelave
I. Gjenerimi i raporteve automatike në formatin excel të regjistrit kadastral shtojca nr.4 e VKM-së 171 datë 18.03.2022
J. Gjenerimi i përshkrimit të parcelave në format pdf ku paraqiten të dhënat bazë të një parcele pyjore aneksi nr. 8 i Manualit të hartimit të PM
K. Një shtresë më vete me hartat e vitit 1985 të gjeoreferuara për tu orientuar në rastin e hartimit të PM të reja. (sipas VKM-së 171, datë 18.03.2022 kapitulli IV, pika 2)
L. Lejer më vete me ndarjen parcelare mbasi ekziston vetëm ndarja nën parcele, ligji i pyjeve njeh dy koncepte hartografimi bazë nën parcelën dhe parcelën
M. Trajnimi

Propozimet e termave të referencës për shërbimin e Mirëmbajtjes:

Afat 2 vjeçar i shërbimit të mirëmbajtjes është caktuar në zbatim të VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".
Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime pro aktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos pasur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/përfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5 <Mund të përcaktohet ndryshe sipas rastit>, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.
(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Perfituesit brenda intervalit kohor prej <Të përcaktohet afati> orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t'i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.
Palët e përfshira duhet të krijojnë një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë <Mund të përcaktohet ndryshe sipas projektit>:

1. Javore
   a. Kontroll i logeve të pajisjeve fizike.
   b. Kontroll i statistikave të hapësirave server/storage (Hapësira e përdorimit të HDD-ve, etj).
   c. Kontroll i statistikave për sistemin.
   d. Kontroll i pajisjeve për probleme.
   e. Të kryejë mirëmbajtje proaktive (mirembajtje parandaluese dhe parashikuese per makinat dhe pajisjet.
   f. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.
2. Mujore.
   a. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit.
   b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware/software.
   c. Rishikim i të dhënave mbi performancë e serverave.
   d. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.
   e. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

Mbështetur në specifikimet teknike (ToR) për përmirësimet e sistemit dhe specifikimet teknike për mirëmbajtjen të sipërpërmendura, AKSHI, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj, ka llogaritur vlerën e kontratës (fondin limit) dhe ka hartuar dokumentet e tenderit. Me Urdhër Prokurimi nr. 52, datë 22.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI, ka filluar procedura e prokurimit me objekt: "Përmirësimi i sistemit të informacionit për pyjet ALFIS", me fond limit **179,034,098 lekë pa TVSH dhe 214,840,917 lekë me TVSH**. Vlera e kontratës është ndarë si më poshtë:
-Përmirësimi i Sistemit Shqiptar të Integruar të Pyjeve (ALFIS) me vlerë 149,678,226 lekë pa TVSH;
-Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit për një periudhë 2-vjeçare me vlerë 29,355,872 lekë pa TVSH.
Procedura e prokurimit ka përfunduar me lidhjen e kontratës Nr. 121, datë 24.12.2024, midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, me cilësinë e Autoritetit Kontraktor, dhe operatorit ekonomik fitues të tenderit, A. T. D. me cilësinë e Kontraktorit. Kontrata ka vlerë totale 158,252,290 lekë pa TVSH dhe 201,902,748 lekë me TVSH, me afat mirëmbajtjeje 24 muaj.
Preventivi i kësaj kontrate pasqyrohet, më poshtë:


Lekë

Nr	Përshkrimi	sasia	Çmimi	Vlera
1	Përmirësimi i Sistemit Shqiptar të integruar të Pyjeve (ALFIS)	1	138,664,290	138,664,290
2	Trajnimi i stafit	1	1,000,000	1,000,000
3	Mirëmbajtja (në vite)	2	13,794,000	27,588,000
	Totali, pa TVSH			**158,252,290**
	TVSH			**33,650,458**
	Totali, me TVSH			**201,902,748**

Kontrata për përmirësimin e sistemit ALFIS ashtu si kontrata e parë ka për qëllim të menaxhojë të gjithë procesin e informacionit që do të mblidhet dhe mbahet nga AKP për monitorimin e fondit pyjor dhe kullosor. Qëllimi i kontratës është [1]:

[1]Pika 5, "Propozime teknike" anekssi i Kontratës Nr.121, date 24.12.2024

-Përmirësimin e sistemit ALFIS, duke shtuar module të reja dhe përmirësuar modulet ekzistuese, duke siguruar përmirësimin e funksionaliteteve dhe disponueshmërinë e pandërprerë të sistemit ALFIS:
-Ngritjen e shërbimeve në portalin e-Albania dhe menaxhimin e tyre në sistem,
-Përmirësimin e sistemit dhe azhurnimin / përditësimin e të dhënave,
-Trajnimi i përdoruesve,
-Mirëmbajtje 24 muaj.
Referuar kësaj kontrate sistemi ALFIS përbëhet nga modulet:
-"Menaxhimi i përdoruesve " përcakton rregullat e autorizimit, si për aksesin e të dhënave ashtu dhe për funksionet e disponueshme, për çdo përdorues që përcakton profilin e tij për të garantuar sigurinë;
-"Katalogu i të dhënave" është moduli që mbledh meta të dhënat e burimeve: të dhëna, dokumente dhe shërbime;
-"Regjistri" është lista e kodeve (Tabela e domenit) të përdorur në ALFIS;
-"Menaxhimi i dokumentit" çdo document do të shoqërohet me meta të dhënat e tij përmes SOLR, një motor kërkimi që ofron kërkim të plotë të tekstit në dokumente;
-"Business process" mbledh të dhëna dhe ofron shërbime pët të mbështetur autoritetet në kryerjen e proceseve të biznesit;
-"FMP_Projekt" moduli lejonë përdoruesin të menaxhojë listën e detyrave për çdo FMP, ose ndërhyrje e parashikuar në FMP: ripyllëzimi, prerja, mirëmbajtja ose ndërtimi i infrastrukturës;
-"Publisher/Botimi" moduli do të lejojë përdoruesin të gjenerojë disa legjenda të përdorura për të shfaqur hartografinë në modulin GIS DATA.
"Menaxhimi i të dhënave GIS", të dhënat GIS janë të dhëna themelore në mjedisin ALFIS dhe kanë të bëjnë me informacione të ndryshe që lidhen me pyjet dhe kullotat. Aktualisht në sistem modulet shfaqen si në print screen e mëposhtëm të marrë nga sistemi ALFIS, konkretisht: 1. "Menaxhimi i përdoruesve", 2. "MPB", 3. "Regjistri", 4. "Projekti PMPK", 5. " Katalogu", si dhe modulet 6. "Menaxhimi i dokumentit", 7. "Publisher/ Botimi" dhe 8. "Menaxhimi i të



dhënave GIS" janë integruar brenda moduleve.

Modulet e sistemit që përmban kjo kontratë pothuajse janë të njëjta me kontratën fillestare Nr. 8368/1, datë 06.12.2018 për "*Sistemin Shqiptar të Informacionit për Pyjet, (ALFIS)*". Konkretisht: Moduli "Regjistri" ('REGISTRY'), moduli 'Business proces' ('Business process-BPM MANAGER'), moduli 'Menaxhimi i dokumentit' ('DOKUMENT') dhe moduli 'Katalogu i të dhënave' ('CATALOGUE').

Ka ndryshimi në përmirësime apo shtesa në përmirësim të funksionalitetit vetëm në 3 module si: në Modulin 'Menaxhimi i përdoruesve' ('USER MANAGEMENT') është ndryshuar mënyra e autentifikimit të përdoruesve në sistem, në modulin 'Menaxhimi i të dhënave GIS' ('GIS DATA') ka ndryshime në ndërfaqe të hartave, në aplikacionin e përdorur si dhe është shtuar 'Integrimi me google wms, openstreetmap, shërbimet street view', 'Hartat tematike' dhe 'Shërbimet gjeohapsinore: WMS/WFS' dhe ndryshime në modulin "FPMP_PROJECT" ("FMP_Project").

Gjithashtu nga auditimi në lidhje me aspektet teknike të sistemit ALFIS që përmban kjo kontratë konstatohet se aspektet teknike të sistemit janë të njëjta me kontratën e parë Nr. 8368/1, datë 06.12.2018. Konkretisht:
-Modulin e të dhënave konceptuale të sistemit;
-Komponentët ALFIS;
-Arkitektura Logjike e sistemit ALFIS;
-Shtresat e të dhënave ALFIS;
-Shtresa e Aplikimit të sistemit;
-Shtresa e Ndërfaqes së sistemit ALFIS

Konkluzion: Kontrata me objekt: "Përmirësimi i sistemit të informacionit për pyjet ALFIS" përmban disa përmirësime të funksionaliteteve dhe tre moduleve, me vlerë totale 138,664,290 lekë pa TVSH (rreth 1,400,000 euro). Këto përmirësime do t'i bëhen vetëm sistemit të softwerëve, të cilët janë blerë nga Banka Botërore në vitin 2018 me vlerë 210,000 euro pa TVSH. Pas përmirësimeve, vlera fillestare e blerjes së sistemit softuer do të rritet nga 210,000 euro në 1,610,000 euro. Pra, kosto e këtij sistemi është rritur me rreth 660%, ose afërsisht 6.6 herë. Këto softwerë, së bashku me pajisjet hardware (server, storage, switch, firewall, SAN switch etj.), të blera nga Banka Botërore me vlerë 165,000 euro, do të mirëmbahen për 24 muaj, me vlerë shërbimi rreth 270,000 euro.

Për sa më sipër, sipas këtij programi auditimi po kryhet vetëm në AKP dhe grupi i auditimit nuk mundi të dal me konkluzion të qartë dhe objektiv në lidhje me vlerën e kontratës sepse e gjithë procedura e llogaritjes së fondit limit dhe e hartimit të Dokumenteve të Tenderit (ToR, kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta, etj.) janë hartuar nga AKSHI dhe nën përgjegjësinë e strukturave të saj.

2.3. Zbatimi i kontratës dhe funksionimi i sistemit "ALFIS"

Nga auditimi u konstatua:

Mbas lidhjes së kontratës nr. 121, datë 24.12.2024, Drejtori i Përgjithshëm i AKP, me Urdhrin Nr. 1, datë 04.02.2025, ka ngritur grupin e punës me 7 anëtarë të AKP-së, për monitorimin e zbatimit të kontratës nga operatori ATD. Grupi i punës, sipas fushës së përgjegjësisë, ka për detyrë të mbështesë dhe të monitorojë zbatimin e kontratës sipas moduleve dhe funksionaliteteve të ALFIS, duke dhënë asistencë teknike mbi aktivitetet e parashikuara për përmirësim, si:

- Parallogaritja e parametrave morfologjikë të parcelave pyjore;
- Përmirësimi/modifikimi i databazës qendrore të aplikacionit Open-Forest për integrim më të mirë me ALFIS;
- Integrimi ALFIS–Open-Forest App dhe llogaritja e indikatorëve nga të dhënat e sipërfaqeve provë, si dhe ngarkimi automatik në databazën ALFIS;
- Implementimi i Planifikimit Vjetor (plani operacional) në ALFIS;

- Ndërhyrje shtesë në databazën ALFIS;
- Ngritja e shërbimeve në portalin e-Albania dhe menaxhimi i tyre në sistem. Në portalin qeveritar e-Albania do të ngrihen shërbimet e mëposhtme dhe do të trajtohen nga marrja e aplikimit deri në kthimin e përgjigjes me nënshkrim elektronik ose vulë dixhitale;
- Krijimi i një shtrese për vendosjen e sipërfaqeve provë të përhershme të një PM dhe të dhënave të terrenit, të cilat do të shërbejnë për llogaritjen e parametrave parcelarë;
- Gjenerimi i raporteve automatike të regjistrit kadastral (shtojca nr. 4 e VKM-së nr. 171, datë 18.03.2022);
- Gjenerimi i përshkrimit parcelar, ku paraqiten të dhënat bazë të një parcele pyjore (aneksi nr. 8 i manualit të hartimit të PM);
- Një shtresë më vete me hartat e vitit 1985 të gjeoreferuara për orientim në rastin e hartimit të PM të reja;
- Shtresë më vete me ndarjen parcelare, pasi aktualisht ekziston vetëm ndarja nënparcelare; Ligji i Pyjeve njeh dy koncepte hartografimi: nënparcela dhe parcela;
- Rishikimi i manualeve.

Periudha e vënies në përdorim të përmirësimeve (implementimit) që do t'i bëhen sistemit ALFIS sipas kontratës nr. 121 prot., datë 24.12.2024, është 9 muaj nga nënshkrimi. Në përfundim të këtij afati, operatori ATD, me shkresën e datës 25.09.2025, ka dorëzuar në AKP:

- Raporti Përfundimtar i Përditësuar
- Dokumentimi i Projektit
- Plani i Mirëmbajtjes Operative për sistemin ALFIS
- Manualet e Administrimit dhe Përdorimit të Sistem
- UAT – Dokumentimi i Pranimit të Testimit
- Raport Trajnimi
- Deklaratë e Përmbushjes së Kërkesave
- Faturë Elektronike me nr. 2055/2025
- Kodi Burimor, i cili do të dërgohet pranë AKSHI

Nga auditimi konstatohet se:

Me qëllim garantimin e një administrimi të sigurt dhe efikas të bazës shtetërore të të dhënave për pyjet, dhe në zbatim të kontratës së sipërcituar, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me Urdhrin nr. 328, datë 04.09.2025, ka miratuar rregulloren: *"Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të të dhënave shtetërore për sistemin Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)"*. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe përgjegjësive për organizimin, funksionimin dhe përdorimin e Sistemit Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS).

Sipas nenit 10 të rregullores, **"Modulet kryesore të sistemit"**, janë:


-Moduli "GIS DATA"
-Moduli "USER MANAGEMENT"
-Moduli **"**BPM"
-Moduli "REGISTRY"
-Moduli "FPMP PROJECT"
-Moduli "CATALOGUE"
-Moduli "ALFIS OPEN FOREST"

-Në këtë rregullore nuk janë përfshirë përshkrimet për modulet "Publisher/Botimi" dhe modulin "Menaxhimi i dokumentit", sipas përshkrimeve në kontratë. Po ashtu, referuar përshkrimit në rregullore, "ALFIS OPEN FOREST" paraqitet si modul, ndërkohë që sipas kontratës, "ALFIS OPEN FOREST" nuk është modul, por funksionalitet.

-Implementimi i këtij sistemi, sipas kontratës, do të zgjasë 9 muaj nga data efektive, dhe fillimi i mirëmbajtjes do të jetë pas dorëzimit (pranimit) të sistemit dhe do të zgjasë për 24 muaj. Periudha e implementimit ka përfunduar në datën 25.09.2025, datë në të cilën ka filluar edhe afati i mirëmbajtjes. Mirëpo, konstatohet se për periudhën janar 2024 deri në shtator 2025, sistemi ALFIS nuk ka pasur një kontratë aktive mirëmbajtjeje, dhe për pasojë ky sistem nuk është përdorur nga AKP deri në shtator 2025. Kjo periudhë pa mbështetje teknike ka krijuar rrezik të lartë për vazhdimësinë e shërbimit dhe integritetin e të dhënave pyjore.
Nga AKP nuk vu në dispozicion të auditimit ndonjë shkresë apo dokument që të justifikojë mospërdorimin e sistemit për shkak të mungesës së kontratës së mirëmbajtjes, por sipas sqarimeve të AKP, sistemi nuk është përdorur për shkak të mungesës së konsulencës teknike, dhe si pasoj gjatë përdorimit të sistemit janë hasur disa problematika të ndryshme të cilat e bënin të pamundur funksionimin normal të tij. Konkretisht problematikat janë hasur në mosfunksionime të moduleve të caktuara, pengesa në proceset operative, si dhe probleme që lidhen me databazën dhe grumbullimin/përpunimin e të dhënave. Për këto arsye, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka vijuar përkohësisht aktivitetin duke u mbështetur edhe në përdorimin e programeve alternative pa pagesë (open source), me qëllim vazhdimësinë e proceseve të punës. Grupi auditimit nuk mundi të evidentoj këto problematikat sepse gjatë periudhës që po ushtrohej auditimi si u trajtua më lart në zbatim të kontratës nr. 121, datë 24.12.2024 përmirësimet e reja ishin implementuar dhe sistemi ALFIS funksiononte normalisht.


- Pas, testimit, pranimit dhe marrjes në dorëzim të përmirësimeve të sistemit ALFIS, konstatohet se implementimi i tij nuk rezulton të jetë përmbyllur plotësisht sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë. Një pjesë e funksionaliteteve dhe zhvillimeve të parashikuara në termat e referencës dhe në kërkesat e institucionit janë ende në proces, ndërsa disa të tjera janë realizuar vetëm pjesërisht, si më poshtë:

- Nuk është realizuar brenda afatit të implementimit, që ishte 9 muaj, konfigurimi në sistem për menaxhimin e dy shërbimeve që ofrohen nëpërmjet e-Albania, respektivisht: aplikimi për Ndryshimin e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo Zgjerimin e tyre, dhe aplikimi për lëshimin e certifikatës së ekspertit për pyjet dhe kullotat. Këto shërbime, deri në momentin e këtij auditimi, nuk ishin realizuar plotësisht nga Operatori Ekonomik, ndërkohë që sistemi është pranuar dhe marrë në dorëzim pa u kryer këto shërbime plotësisht.
- Gjithashtu, gjatë testimeve të sistemit nga grupi i auditimit konstatohet se menaxhimi i këtyre dy shërbimeve nëpërmjet sistemit ALFIS është jashtë funksionit, duke shfaqur errore, siç tregohet më poshtë:



- Lidhur me hartat e vitit 1985 të gjeoreferuara, të cilat përdoren për orientim në rastin e hartimit të PM të reja, sipas VKM-së nr. 171, datë 18.03.2022, kapitulli IV, pika 2), konstatohet se është realizuar vetëm pjesërisht, pasi në sistem janë aktive vetëm katër bashki: Bulqizë, Dibër, Kamëz dhe Himarë.
- Gjenerimi i raporteve automatike në format Excel dhe PDF të regjistrit kadastral, sipas shtojcës nr. 4 të VKM-së nr. 171, datë 18.03.2022, ka nevojë për formatim dhe rishikim të formatit.
- Gjenerimi i përshkrimit parcelar në format PDF, ku paraqiten të dhënat bazë të një parcele pyjore, sipas aneksit nr. 8 të Manualit të hartimit të PM, është realizuar vetëm pjesërisht, pasi ka nevojë për rregullim të formatit.
- Automatizimi i proceseve të përditësimit të sistemit për Inventarin Kombëtar të Pyjeve dhe përshtatja e aplikacionit OPEN-FORIS me sistemin ALFIS është ende në proces realizimi.
- Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion vetëm një workflow i dokumentuar për dy procese në sistem, konkretisht për modulin "FPMP PROJECT" dhe "Business Process", të cilët nuk janë të miratuar. Gjithashtu, sipas përgjigjes së informacionit nr. 1, datë 12.01.2026, të vënë në dispozicion nga subjekti i auditimit, akoma nuk është dakordësuar nga ana e AKP skema e workflow-t të sistemit ALFIS. Nga auditimi u konstatua se nuk janë dokumentuar diagramat e rrjedhës së informacionit për çdo produkt apo shërbim të konfiguruar në sistemin ALFIS. Në këto kushte, grupi i auditimit nuk administrua një dokumentim skematik mbi proceset, rregullat dhe procedurat e implementuara për çdo modul apo shërbim të informatizuar në sistemin ALFIS.

-Konstatohet se shtimi i "Modulit të Planifikimit Vjetor në ALFIS", sipas specifikimeve të kontratës, ka qenë modul i përfshirë edhe në kontratën e parë nr. 8368/1, datë 06.12.2018, konkretisht në pikat 7. Business Process – BMP Management dhe 7.1 Business Process.
Në këtë modul përshkruhen proceset e punës që janë në ngarkim të MTM, AKP, AKZM, bashkive dhe ADZM-së.
. Rrjedha e punës për këto procese është e shpjeguar dhe tregohet qartë në sesionet 8.1.1 dhe 8.1 BP 1 – FMP DESIGN të kontratës nr. 8368/1, datë 06.12.2018. Pra, ky modul nuk është modul i ri në tërësi, por në të është shtuar vetëm një proces – ai i punës për Fakultetin Kombëtar të Pyjeve.
-Gjatë testimit nga grupi i auditimit për mirëfunksionimin e sistemit ALFIS rezultoi se:
Opsioni "Raportet" për shkarkimin në format PDF/CSV të materialeve që shfaqen për t'u shkarkuar në format CSV është i paaktivizuar, ndërsa opsioni PDF disa herë nuk funksionon, duke shfaqur informacionin si më poshtë:



- Nga testimi i sigurisë së sistemit, në lidhje me autentifikimin e përdoruesve duke përdorur fjalëkalime jo të sakta tri herë radhazi, rezultoi se llogaria e përdoruesit nuk bllokohet automatikisht përkohësisht për 15 minuta. Kjo është në kundërshtim me nenin 14, "Zhbllokimi i Llogarive", të Rregullores nr. 328, datë 04.09.2025, "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të të dhënave shtetërore për sistemin Shqiptar të Informacionit për pyjet ALFIS", e miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

- Në ekstraktin mbi përdoruesit e sistemit, të krijuar për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të tij, konstatohet se disponohen 5 kategori përdoruesish. Konkretisht: 99 përdorues për bashkitë; 9 përdorues për AKP; 25 përdorues për AKZM dhe ADZM; 3 përdorues për MTM; dhe 4 përdorues për Fakultetin. Nga auditimi i përdoruesve të hapur në sistem rezultoi se ata mbartin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara dhe rrezikojnë të mos lënë gjurmë mbi aktivitetin e kryer, pasi:

- Janë hapur përdorues pa "pozicion" në sistem: 42 përdorues për bashkitë;
- Ekzistojnë përdorues pa "nr. kontakti": 19 përdorues për bashkitë dhe 2 përdorues për AKZM;
- Janë hapur përdorues me email jozyrtar: 22 përdorues për bashkitë dhe 5 përdorues për AKZM.

-Ky sistem dhe gjithë infrastruktura fizike hostohet në Datacenter-in qeveritar të AKSHI. Infrastruktura hardware përbëhet nga komponentë të ndryshëm, si pajisjet mbi të cilat hostohet aplikacioni dhe baza e të dhënave (servera, SAN Storage dhe komponentët e tyre), si dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e komponentit të "Komunikimit në Rrjet".
Gjithashtu, për infrastrukturën hardware të sistemit ALFIS është ndërtuar edhe një infrastrukturë dytësore (Site Sekondar), identike me infrastrukturën parësore.
Në kontratën Nr. 121 prot., datë 24.12.2024, përcaktohet se Site Primar i infrastrukturës së sistemit ALFIS ndodhet në ambientet e Datacenter-it Qeveritar pranë AKSHI. Po ashtu, Site Sekondar hostohet gjithashtu në ambientet e Datacenter-it Qeveritar pranë AKSHI. Site Sekondar është vendosur në të njëjtat ambiente pranë AKSHI, në një largësi gjeografike që nuk përputhet me praktikat më të mira ndërkombëtare. Sipas këtyre praktikave, ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë në një pozicion gjeografik me risk shumë të ulët që të preket nga i njëjti incident ose fatkeqësi natyrore që ndodh në ambientin primar, minimalisht 50 km largësi në vijë ajrore. Kjo është gjithashtu në kundërshtim me pikën 1, shkronja e), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdimësisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 190/5 prot. datë 08.07.2026 "Komente dhe shpjegime në lidhje me projekt-raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt "Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me konstatimin për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2025 nuk u paraqitën raporte për monitorimin e kontratës", AKP ka dërguar bashkëlidhur observacioneve raportet e monitorimin e kontratës për periudhat tetor, nëntor dhe dhjetor 2025

Lidhur me hartat e vitit 1985 të gjeoreferuara, të cilat përdoren për orientim në rastin e hartimit të PM-ve të reja, sipas VKM-së nr. 171, datë 18.03.2022, kapitulli IV, pika 2), janë rikthyer aktive në sistem.

Në asnjë dokument nuk kemi kërkuar zhvillimin e një moduli të ri. Në Termat e Referencës kemi paraqitur qartë kërkesën për përmirësimin e funksionalitetit të planifikimit vjetor, si më poshtë vijon (ToR dërguar AKSHI-t me email të datës 12.07.2023)…

Lidhur me shkarkimet ne CSV/PDF ka qenë kërkesë e AKSHI-t që raportet, për arsye sigurie, të mos shkarkohen në format të aksesueshëm, bazuar në rregulloren e tyre për publikimin e informacionit. Lidhur me konstatimet dhe rekomandimet ku përmendet AKSHI kemi vënë në dijeni dy ndjekësit e kontratës përfaqësues të AKSHI-t.

Qëndrimi i grupit të auditimit Për konstatimin se, "për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2025 nuk u paraqitën raporte për monitorimin e kontratës", AKP ka dërguar bashkëlidhur observacioneve raportet e monitorimin e kontratës për periudhat tetor, nëntor dhe dhjetor 2025 dhe për rrjedhojë ky observim merret në konsideratë dhe reflektohet në këtë raport auditimi. Me këto observacione AKP nuk kundërshton rritjen e vlerës së softuerëve, sepse llogaritja e fondit limit të kontratës është bërë nga AKSHI.

Observacionet e paraqitura në lidhje me konstatimet që kanë të bëjnë me implementimin e përmirësimeve me karakter teknik nuk merren në konsideratë, pasi nuk janë shoqëruar me argumente dhe dokumentacion mbështetës që të kundërshtojnë ose rrëzojnë konstatimet e grupit të auditimit. Për rrjedhojë, konstatimet mbeten të pandryshuara dhe janë reflektuar në Raportin e Auditimit.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk disponon strategji institucionale që të përfshijë edhe strategjinë e teknologjisë së informacionit, në funksion të mbështetjes së objektivave institucionalë sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 27001:2022. Gjithashtu, mungojnë rregullat e brendshme për veprimtarinë dhe menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit, përfshirë, menaxhimin e incidenteve, matjen e performancës,
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategji institucionale në përputhje me objektivat institucionalë që përfshin dhe strategjinë e teknologjisë së informacionit, si dhe të zhvillojë rregulloret e brendshme për Menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit në përputhje me standardet ISO/IEC 27001:2022.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2027

2. Gjetje nga auditimi: Në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve nuk rezulton të jetë atashuar asnjë punonjës i teknologjisë së informacionit nga AKSHI sipas kërkesave të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, *"Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"*. Ky mosveprim krijon mungesë të kapaciteteve të specializuara për administrimin e infrastrukturës TIK, si dhe ekspozon institucionin ndaj një niveli të lartë risku në drejtim të sigurisë, funksionimit dhe vazhdimësisë së sistemeve të informacionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për sigurimin e mbulimit të funksioneve të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet atashimit të një specialisti teknologjisë së informacionit ose përcaktimit të një strukture përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës së Tekonologjisë së Informacionit dhe komunikimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, AKP nuk e ka përfunduar procesin e dorëzimit të Infrastrukturës "hardware" të Teknologjisë së Informacionit ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, pika 18 *"Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përfundimin e procesit të dorëzimit të infrastrukturës "hardware" TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka dokumentuar dhe zbatuar një proces të plotë për identifikimin e nevojave për trajnim në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Për periudhën objekt auditimi 2024–2025 nuk rezulton të jetë hartuar plan trajnimi vjetor apo plan periodik për trajnimin e përdoruesve të pajisjeve dhe sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e ISSAI 5310.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të hartojë dhe zbatojë një proces të plotë për identifikimin e nevojave për trajnim në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe një plan vjetor trajnimi për stafin që administron sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe për përdoruesit e pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk disponon regjistër risku për identifikimin, vlerësimin, kontrollin, përgjegjësitë për menaxhimin dhe dokumentimin e risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit sipas kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe standardeve ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për hartimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të riskut për teknologjinë e informacionit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në infrastrukturën e publikuar nën domenin "alfis.gov.al", të administruar nga AKSHI, rezulton e hapur dhe e aksesueshme publikisht porta 23/TCP (Telnet). Gjatë verifikimit teknik u evidentua se shërbimi "Telnet"

është i ekspozuar ndaj aksesit nga rrjeti publik, duke krijuar risk për sigurinë e sistemit në kundërshtim me standardet ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të ndërmarrë masa për çaktivizimin e shërbimeve të pasigurta të aksesueshme publikisht, si Telnet në domenin "alfis.gov.al", dhe të zëvendësojë ato me protokolle të sigurta, si SSH (secure shell), me qëllim uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve të sigurisë**.**

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se mbrojtja e rrjetit në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve realizohet vetëm përmes funksionaliteteve të integruara në pajisjen router, pa përdorimin e një pajisjeje firewall të dedikuar, duke sjellë reduktim të nivelit të sigurisë dhe kontrollit të trafikut të rrjetit. Gjithashtu, institucioni përdor vetëm një lidhje primare interneti dhe nuk ka të implementuar lidhje redundante (backup), duke rritur riskun për ndërprerje të shërbimeve dhe mungesë të vazhdimësisë së operacioneve në rast dështimi të linjës në mos përputhje me praktikat e rekomanduara dhe kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve duhet të vlerësojë dhe të implementojë përdorimin e një pajisjeje firewall të dedikuar për mbrojtjen e rrjetit, si dhe të sigurojë një lidhje interneti redundante (backup), për rritjen e nivelit të sigurisë dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve në rast ndërprerjeje të linjës kryesore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në kuadër të Projektit të Shërbimeve Mjedisore të financuar nga Banka Botërore pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), është financuar ngritja dhe funksionimi i Sistemit Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS). Në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur Kontrata nr. 8368/1, datë 06.12.2018, ndërmjet MTM dhe operatorit ekonomik fitues, me vlerë 375,000 euro pa TVSH.
Kontrata përfshinte zhvillimin e komponentit softuerik të sistemit ALFIS në vlerën 210,000 euro pa TVSH dhe furnizimin me pajisje harduerike në vlerën 165,000 euro pa TVSH. Zbatimi i kontratës ka filluar më 27.11.2018 dhe, pas përfundimit të periudhës 36-mujore të garancisë për defektet, kontrata është mbyllur në muajin mars 2022.
Pas përfundimit të kësaj kontrate, AKSHI zhvilloi procedurën e prokurimit dhe lidhi Kontratën nr. 121, datë 24.12.2024, me objekt **"Përmirësimi i sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)"**, me vlerë totale 158,252,290 lekë pa TVSH, nga të cilat 139,664,290 lekë për përmirësimin e sistemit dhe 27,588,000 lekë për shërbimin e mirëmbajtjes për një periudhë dyvjeçare.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, nga përfundimi i kontratës së parë në muajin mars 2022 deri në përfundimin e implementimit të përmirësimeve të parashikuara në kontratën nr. 121, në muajin shtator 2025, sistemi ALFIS nuk është vënë në përdorim nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, pasi nga ky institucion nuk ishte siguruar shërbimi i mirëmbajtjes. Mungesa e mbështetjes teknike për një periudhë të zgjatur duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit*" ka krijuar rrezik për ndërprerjen e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit, cenimin e integritetit të të dhënave dhe mosrealizimin e objektivave për të cilat sistemi ALFIS është financuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të periudhës së mirëmbajtjes të parashikuar në Kontratën nr. 121, datë 24.12.2024, të kërkojë pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit ndërmarrjen e procedurave për sigurimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit "Përmirësimi i sistemit shqiptar të integruar të

informacionit për pyjet (ALFIS)", për garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemit dhe shmangien e ndërprerjes së mbështetjes teknike.

Tre muaj përpara përfundimit të kontratës

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në përfundim të Kontratës nr. 8368/1, datë 06.12.2018, AKSHI, me Urdhrin nr. 62, datë 14.02.2022, ngriti grupin e punës për hartimin e termave të referencës (ToR) për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt mirëmbajtjen e Sistemit Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS). Në këtë grup pune morën pjesë edhe dy përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (AKP), të cilët hartuan draftin e termave të referencës dhe e përcollën pranë AKSHI-t me email, datë 02.03.2022.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit, AKSHI, me shkresën nr. 7379, datë 21.11.2022, njoftoi AKP se objekti i prokurimit duhej të ndryshohej, duke përfshirë, përveç mirëmbajtjes së sistemit, edhe përmirësime funksionale të tij, me argumentin se kërkesat e paraqitura tejkalonin kuadrin teknik të shërbimit të mirëmbajtjes.
Në vijim, AKP hartoi termat e referencës për përmirësimin e sistemit ALFIS dhe i përcolli pranë AKSHI me email, datë 01.09.2023. Nga krahasimi i dokumentacionit të administruar rezulton se termat e referencës të datës 01.09.2023 paraqesin, në pjesën më të madhe, përmbajtje të njëjtë me ato të hartuara fillimisht për procedurën e mirëmbajtjes, të datës 02.03.2022. ***Ky fakt tregon se kërkesat funksionale të paraqitura nga AKP kanë mbetur në thelb të pandryshuara, ndërsa është ndryshuar objekti i procedurës së prokurimit nga "mirëmbajtje" në "përmirësim dhe mirëmbajtje".***
Gjithashtu, rezultoi se AKP, nëpërmjet shkresave nr. 129, datë 01.02.2024 dhe nr. 129/4, datë 24.09.2024, ka informuar në mënyrë të vazhdueshme AKSHI-n mbi vonesat në zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe ka kërkuar përshpejtimin e saj, duke evidentuar nevojën për vënien në funksion të sistemit ALFIS.
Në përfundim të procedurës, AKSHI përllogariti fondin limit dhe hartoi dokumentet standarde të tenderit mbi bazën e draft termave të referencës të paraqitura nga AKP. Me Urdhrin e Prokurimit nr. 52, datë 22.10.2024, u zhvillua procedura me objekt "Përmirësimi i sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)", me fond limit 179,034,098 lekë pa TVSH, nga të cilat 149,678,226 lekë për përmirësimin e sistemit dhe 29,355,872 lekë për mirëmbajtjen për një periudhë dyvjeçare. Procedura përfundoi me lidhjen e Kontratës nr. 121, datë 24.12.2024, ndërmjet AKSHI dhe operatorit ekonomik fitues, me vlerë totale 158,252,290 lekë pa TVSH, nga të cilat 139,664,290 lekë për përmirësimin e sistemit dhe 27,588,000 lekë për shërbimin e mirëmbajtjes për dy vjet.
Nga auditimi rezultoi se, megjithëse AKP ishte institucioni përfitues i këtij investimi, pjesëmarrja e saj në procesin e prokurimit u kufizua vetëm në draft-hartimin e termave të referencës. AKP nuk mori pjesë me përfaqësues në grupet e punës për përllogaritjen e fondit limit, hartimin e dokumenteve të tenderit (kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës) dhe në vlerësimin e ofertave, çka kufizoi mundësinë e saj për të kontribuar në vlerësimin e nevojave funksionale dhe ekonomicitetit të investimit.
Nga analiza financiare rezultoi se përmirësimet e kontraktuara për komponentin softuerik arrijnë vlerën 167,597,148 lekë me TVSH (rreth 1,680,000 euro), ndërkohë që zhvillimi fillestar i këtij komponenti në vitin 2019 ishte kontraktuar me vlerë 252,000 euro me TVSH. Si rrjedhojë, investimi i përgjithshëm në komponentin softuerik arrin në rreth 1,932,000 euro me TVSH, duke reflektuar një rritje prej rreth **1,680,000 euro ose 766%** krahasuar me investimin fillestar. Paralelisht, për mirëmbajtjen dyvjeçare të sistemit është kontraktuar edhe një fond prej 33,105,000 lekë me TVSH ose rreth **324,000 euro.**
Sa më sipër evidenton nevojën që institucioni përfitues të përfshihet në të gjitha fazat e procesit të prokurimit, me qëllim garantimin e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës së investimeve në teknologjinë e informacionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13–25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

9.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në cilësinë e institucionit përfitues të investimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të sigurojë përfaqësimin e saj jo vetëm në grupet e punës për hartimin e termave të referencës, por edhe në grupet e punës për përllogaritjen e fondit limit, hartimin e dokumenteve të tenderit dhe vlerësimin e ofertave, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së investimit me nevojat funksionale të institucionit, si dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në zbatim të Kontratës nr. 121, datë 24.12.2024, me objekt "Përmirësimi i sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)", Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me Urdhrin nr. 328, datë 04.09.2025, ka miratuar rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të të dhënave shtetërore për Sistemin Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)".
Nga krahasimi i përmbajtjes së kësaj rregulloreje me specifikimet teknike dhe funksionale të kontratës rezultoi se në rregullore nuk janë pasqyruar modulet "Publisher/Botimi" dhe "Menaxhimi i dokumentit", të cilat parashikohen shprehimisht në dokumentacionin kontraktor. Gjithashtu, në rregullore "ALFIS OPEN FOREST" është trajtuar si modul i sistemit, ndërkohë që, sipas specifikimeve teknike të kontratës, ai përbën një funksionalitet të sistemit dhe jo një modul më vete.
Si rrjedhojë, përmbajtja e rregullores nuk është plotësisht e harmonizuar me dokumentacionin kontraktor mbi të cilin është zhvilluar investimi, duke krijuar mosrakordim ndërmjet kuadrit rregullator dhe arkitekturës funksionale të sistemit ALFIS. Ky mos akordim mund të sjellë paqartësi në administrimin, përdorimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit, si dhe në përcaktimin e përgjegjësive të strukturave përgjegjëse për administrimin e tij.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13–25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)
10.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa dhe t'i kërkojë Ministrisë së Mjedisit rishikimin dhe harmonizimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të të dhënave shtetërore për Sistemin Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)", në mënyrë që përshkrimi i moduleve dhe funksionaliteteve të sistemit të jetë në përputhje me specifikimet teknike dhe funksionale të përcaktuara në Kontratën nr. 121, datë 24.12.2024, me objekt "Përmirësimi i sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)".

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimet mbi testimin e sistemit për mirëfunksionimin e tij, u konstatua se, implementimi nuk është përmbyllur plotësisht dhe në përputhje me Termat e Referencës të përcaktuara në kontratë. Një pjesë e funksionaliteteve dhe zhvillimeve të sistemit janë ende në proces, ndërsa disa të tjera janë realizuar pjesërisht. Konkretisht:

- Nuk është realizuar plotësisht, brenda afatit të implementimit, konfigurimi në sistem i dy shërbimeve që ofrohen nëpërmjet e-Albania, si: aplikimi për ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, si dhe aplikimi për lëshimin e certifikatës së ekspertit për pyjet dhe kullotat. Menaxhimi i këtyre shërbimeve nëpërmjet sistemit ALFIS është jashtë funksionit, pasi në ekran shfaqet vetëm shenja "error";
- Hartat e vitit 1985, të gjeoreferuara për orientim në hartimin e planeve të menaxhimit (PM) të reja, janë realizuar pjesërisht, pasi në sistem janë aktive vetëm bashkitë: Bulqizë, Dibër, Kamëz dhe Himarë;
- Gjenerimi i raporteve automatike në format Excel dhe PDF të regjistrit kadastral ka nevojë për formatim dhe rishikim;
- Gjenerimi i përshkrimit parcelar në format PDF, ku paraqiten të dhënat bazë të një parcele pyjore, është realizuar pjesërisht dhe kërkon rregullim të formatit;

- Automatizimi i proceseve të përditësimit të sistemit për Inventarin Kombëtar të Pyjeve dhe përshtatja e aplikacionit OPEN-FORIS me sistemin ALFIS janë ende në proces.
- *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për realizimin e të gjitha funksionaliteteve nga Operatori Ekonomik, në zbatim të Termave të Referencës, sipas Kontratës nr. 121, datë 24.12.2024 "Përmirësimin e sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)".

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nuk janë dokumentuar diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo produkt apo shërbim të konfiguruar në sistemin ALFIS. Në këto kushte, nuk u administrua një dokumentim skematik mbi proceset, rregullat dhe procedurat e implementuara për çdo modul apo shërbim të informatizuar në sistem. Është paraqitur dhe vënë në dispozicion vetëm një workflow i dokumentuar për dy procese në sistem, për modulin "FPMP PROJECT" dhe modulin "Business Process", të cilat janë të pamiratuara. Gjithashtu, skema e workflow-t të sistemit ALFIS ende nuk është dakordësuar nga AKP në përputhje me kontratën "Përmirësimin e sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)"
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve në bashkëpunim me operatorin ekonomik të kontraktuar për "Përmirësimin e sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)", të marrë masa për hartimin dhe dokumentimin e diagramës rrjedhëse së informacionit për gjurmimin e proceseve të automatizuara për çdo proces të realizuar nëpërmjet këtij sistemi.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i sigurisë së sistemit për autentifikimin e përdoruesve rezultoi se llogaria e përdoruesit nuk bllokohet automatikisht përkohësisht për 15 minuta, në kundërshtim me Rregulloren nr.328, datë 04.09.2025*"Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të të dhënave shtetërore për sistemin Shqiptar të Informacionit për Pyjet (ALFIS)"*. Nga ky veprim krijohet risk i lartë për hyrje të pa autorizuara në sistem.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përditësimin e kritereve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në sistemin ALFIS, në përputhje me rregulloren përkatëse.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Të dhënat shtetërore të sistemit shqiptar të informacionit për pyjet (ALFIS), si dhe infrastruktura fizike e këtij sistemi, hostohen në datacenter-in qeveritar të AKSHI-t. Si site primar ashtu edhe site sekondar ndodhen në të njëjtin datacenter. Konstatohet se site sekondar nuk është vendosur në një largësi gjeografike në përputhje me kërkesat e VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *"Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit"* dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Sipas këtyre praktikave, ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë në një pozicion gjeografik me risk të ulët për t'u prekur nga i njëjti incident apo fatkeqësi natyrore si ambienti primar, me një distancë minimale prej 50 km në vijë ajrore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masat e nevojshme për vendosjen e site-it sekondar të sistemit "Përmirësimi i sistemit shqiptar të integruar të informacionit për pyjet (ALFIS)" në një largësi gjeografike, sipas standardeve të kërkuara.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT